



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.9.2023

Nr: 774

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË TEMAVE TË TRAJNIMIT QË DO TË PËRDOREN PËR  
TRAJNIMIN E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË  
BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "b" dhe "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Dekretit të Presidentit, nr. 186, datë 11.08.2023, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të bashkisë Kukës", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Miratimin e programeve të temave të trajnimit që do të përdoren për trajnimin e administratës zgjedhore, si më poshtë:
  - a) Programi i temave të trajnimit për trajnimin e anëtarëve të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi,
  - b) Programi i temave të trajnimit për trajnimin e anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi,
  - c) Programi i temave të trajnimit për trajnimin e anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave sipas lidhjes nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Administratës Zgjedhore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendimin hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

Sektori i Dokumentacionit Zgjedhor dhe Trajnimeve

# PROGRAM I TEMAVE TË TRAJNIMIT

“PËR ANËTARËT E GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE”



ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS

24 SHTATOR 2023





**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE  
Sektori i Dokumentacionit Zgjedhor dhe Trajnimeve

**PROGRAM I TEMAVE TË TRAJNIMIT**

“PËR ANËTARËT E GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE”

ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023

**I. TË PËRGJITHËSHME**

Emërtimi i programit të temave të trajnimit	Trajnim i KQV
Target grupi që trajnohet	Anëtarët e GNV
Numri i pjesëmarrësve që do të trajnohen	80 anëtarë
Lloji i trajnimit	I drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja e trajnimit	2 Orë
Struktura propozuese	Drejtorja e Administratës Zgjedhore
Periudha e trajnimit	24 Shtator 2023
Vendi i zhvillimit të trajnimit	Bashkia Kukës, Ambientet e VNV Nr. 11, “Shkolla Lidhja e Prizrenit”
Struktura që zhvillon trajnimin	Drejtorja e Administratës Zgjedhore



## **II. TË DHËNA MBI PROGRAMIN**

<b>1. OBJEKTIVAT .....</b>	<b>3</b>
<b>2. PROFILI I ANËTARËVE TË TARGET GRUPIT QË TRAJNOHET.....</b>	<b>3</b>
<b>3. TEMAT PËR TRAJNIM .....</b>	<b>3</b>
3.1 Parimet e përgjithshme të zgjedhjeve dhe rregullat e etikës.....	3
3.2 Rregulla në Vendin e Numërimit të Votave .....	3
3.3 Përbërja e GNV.....	3
3.4 Llojet e votave dhe kriteret e vlerësimit të tyre .....	3
3.5 Procesi i numërimit të votave.....	4
I. Vendimi për fillimin e procesit të numërimit të votave.....	4
II. Veprime paraprake të GNV për fillimin e procesit të numërimit të votave .....	4
III. Hapja e kutisë së votimit .....	4
IV. Numërimi i fletëve të votimit.....	5
V. Vlerësimi i fletëve të votimit nga faqja e pasme.....	5
VI. Vlerësimi i votave.....	5
VII. Kontestimi dhe rivlerësimi i votës.....	6
3.6 Hapja e kutisë së materialeve të votimit .....	6
I. Rrethanat që cojnë në hapjen e kutisë së materialeve të votimit.....	6
II. Veprimet me kutinë e materialeve të votimit .....	6
3.7 Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga GNV për qendrën e votimit .....	7
I. Plotësimi i tabelës së rezultateve .....	7
II. Dërgimi i rezultateve për çdo qendër votimi në KQZ nga KZAZ.....	8
III. Mbyllja e kutisë me fletët e votimit .....	8
3.8 Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ.....	8
<b>4. MATJA E REZULTATEVE TË TRAJNIMIT .....</b>	<b>8</b>



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

## 1. OBJEKTIVAT

Njohja e anëtarëve të GNV me detyrat e tyre për numërimin e votave, vlerësimin e fletëve të votimit dhe votave si dhe nxjerrjen e rezultateve për çdo qendër votimi.

## 2. PROFILI I ANËTARËVE TË TARGETGRUPIT QË TRAJNOHET

Anëtarët e GNV duhet të gëzojnë të drejtën për të qenë zgjedhës e të jenë me vendbanim në zonën përkatëse zgjedhore.

## 3. TEMAT PËR TRAJNIM

### 3.1 Parimet e përgjithshme të zgjedhjeve dhe rregullat e etikës

Në këtë temë do të trajtohen rregullat e etikës, njohja e tyre dhe domosdoshmëria e zbatimit të tyre si ligjshmëria, transparenca, kolegjaliteti, paanësia, pavarësia dhe objektiviteti.

### 3.2 Rregulla në vendin e numërimit të votave

Grupet e numërimit të votave kryejnë, në mënyrë të pandërprerë, numërimin e të gjitha kutive të pranuar të rregullta nga ana e KZAZ-së. Refuzimi për të numëruar sjell shkarkimin e menjëhershëm të personave të ngarkuar për numërimin ose, sipas rastit, KZAZ-së. Refuzimi për të numëruar kutinë e pranuar si të rregullt përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 330/a të Kodit Penal.

### 3.3 Përbërja e GNV

Grupet e numërimit përbëhen nga 4 persona nga të cilët një është numërues i parë, një sekretar dhe 2 anëtarë. Në zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023, në GNV me numër çift numëruesi i parë emërohet nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe sekretari nga Partia e Lirisë, ndërsa në GNV me numër tek, numëruesi i parë emërohet nga Partia e Lirisë dhe sekretari nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

### 3.4 Llojet e votave dhe kriteret e vlerësimit të tyre

Fletët e votimit të vlerësuara nga Grupi i Numërimit, ndahen në vota të vlefshme, vota të pavlefshme. Konsiderohen vota të vlefshme, fletët e votimit për kryetar bashkie në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga kandidatët për kryetar bashkie.

Konsiderohet votë e pavlefshme, fleta e votimit që nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja apo kur fletës së votimit i mungojnë një ose dy vultat në pjesën e pasme të saj, përkatësisht vulën e KQV si dhe atë të kryetarit të KQV. Votë e pavlefshme është edhe kur në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës. Votë e pavlefshme është edhe kur në fletën e votimit për kryetarin e bashkisë janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatit. Gjithashtu, e pavlefshme konsiderohet vota edhe kur në fletën e votimit për kryetarin e bashkisë është votuar për më shumë se një nga kandidatët për kryetar bashkie. Kur zgjedhësi nuk ka votuar në fletën e votimit për asnjë nga kandidatët për kryetarë bashkie apo edhe kur nuk është e qartë se për kë zgjedhësi ka votuar, fleta e votimit konsiderohet votë e pavlefshme.

Grupi i Numërimit, për vlerësimin e çdo vote, synon të identifikojë sa të jetë e mundur qëllimin e zgjedhësit.



### 3.5 Procesi i numërimit të votave

#### I. Vendimi për fillimin e procesit të numërimit të votave

GNV fillon numërimin e votave pas marrjes së vendimit nga KZAZ.

Në vendimin për fillimin e numërimit të votave shënohet ora e saktë e fillimit të procesit të numërimit të votave.

Kutitë e votimit me fletët e votimit të pranuar si të rregullta në çdo rast u nënshtrohen procedurave të hapjes dhe numërimit nga GNV. Procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjitha kutive të pranuar të rregullta nga ana e KZAZ-së.

Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së, vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit. Shkaqet argumentohen në “Librin e Protokollit të Mbledhjeve” të KZAZ-së, përfshirë dhe vendimin për rifillimin e numërimit.

#### II. Veprime paraprake të GNV për fillimin e procesit të numërimit të votave

Sekretari i Grupit të Numërimit nën kujdesin e një anëtar të ngarkuar nga KZAZ-ja:

- i. merr me radhë dhe sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, kutinë e votimit me fletët e votimit të vetëm një Qendre Votimi dhe e vendos atë pranë tavolinës së Grupit të Numërimit;
- ii. vendos/ngjit në tavolinën e përcaktuar nga KZAZ etiketën adezive dhe shkruan numrin e qendrës së votimit që numërohet;
- iii. merr nga sekretari i KZAZ-së, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV.

#### III. Hapja e kutisë së votimit

Për hapjen e kutisë së votimit, numëruesi i parë ka për të përmbushur një sërë detyrash. Së pari ai duhet të vendosë mbi tryezë kutinë me fletët e votimit dhe të ekspozojë atë në kamera për jo më pak se 2 sekonda në faqen anësore ku është vendosur etiketa me numrin e qendrës së votimit. Më pas, numëruesi i parë këput vulat me kodet e sigurisë si dhe nxjerr nga kutia e votimit “Procesverbalin e Mbylljes së Votimit”.

Pas kësaj, Grupi i numërimit të votave verifikon të dhënat e plotësuara në procesverbalin e mbylljes së votimit.

Numëruesi i parë dhe anëtarët e grupeve të numërimit nxjerrin nga kutia fletët e votimit dhe zarfin me “Procesverbalin e Vulosjes”. Ata shpalosin fletët e votimit dhe i vendosin mbi tryezë me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Kur ka fletë votimi që i përkasin një organi tjetër ato lihen mënjanë, pa bërë vlerësim. Në përfundim të numërimit të kutisë, këto fletë futen në zarfin me shënimin “Vota të hedhura gabim”, të ndara në zarfe të veçanta, sipas llojit të organit për të cilin janë hedhur.

Nëse procesverbalit për mbylljen e votimit gjendet në kutinë me fletët e votimit dhe është plotësuar saktë, GNV fillon procedurat për numërimin e votave dhe vlerësimin e fletëve të votimit.



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

#### **IV. Numërimi i fletëve të votimit**

Numëruesi i parë i GNV është personi që numëron fletët e votimit të shpalosura dhe të stivuara. Ai, në përfundim të numërimit, ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

Gjithashtu, numëruesi i parë verifikon shifrën e deklaruar duke përfshirë edhe me shifrën e votave të hedhura gabim me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në “Procesverbalin për mbylljen e votimit”. Numëruesi i parë rifillon numërimin e fletëve të votimit nëse shifra nuk përputhet, ose nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të GNV.

Kur konstatohen mospërputhje, atëherë GNV ose vëzhgues të subjekteve zgjedhore që bëjnë konstatimin, pa lëvizur nga vendi dhe duke ngritur dorën, njoftojnë KZAZ. Derisa KZAZ të verifikojë rastin, procesi mbetet i pezulluar dhe GNV nuk kryen veprime të mëtejshme.

Sekretari i KZAZ pasqyron pasaktësinë në Procesverbalin e Konstatimit vetëm pasi KZAZ e ka konfirmuar atë. KZAZ merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga GNV-ja dhe ky vendim i njoftohet GNV.

#### **V. Vlerësimi i fletëve të votimit nga faqja e pasme**

GNV-ja, në tavolinën e numërimit, përcakton vendet e veçanta për fletët e votimit: të vlefshme, të pavlefshme, të kontestuara. Gjithashtu, GNV, në tavolinën e numërimit, në hapësirën e caktuar për votat e vlefshme, përcakton vende të veçanta për grupime të fletëve të votimit të vlefshme për çdo kandidat.

Numëruesi i parë, hap në mënyrë të plotë çdo fletë votimi, i vendos një nga një fletët e votimit në kamerën regjistruese, fillimisht nga faqja e pasme, jo më pak se 3 sekonda, në mënyrë që të shihen qartë në monitor vula e KQV-së dhe Vula e Kryetarit të KQV-së. Njëkohësisht, numëruesi i parë, gjatë këtij procesi, verifikon nëse fleta e votimit ka të njëjtën madhësi, formë dhe ngjyrë, me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja, është vulosur me vulën e KQV-së dhe me vulën e Kryetarit të KQV-së apo ka shënime, shenja apo nënshkrime, që bëjnë të mundur identifikimin e zgjedhësit. Gjatë këtij verifikimi, numëruesi i parë, shprehet me zë të lartë vetëm për fletët e votimit, të cilat i konsideron të pavlefshme gjatë vlerësimit nga faqja e pasme.

Në rast se ndonjë nga anëtarët e GNV ose ndonjë prej vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nuk është dakord me vlerësimin e mësipërm, numëruesi i parë e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara (e cila do të vlerësohet përsëri nga GNV në momentin e rivlerësimit të votave) dhe vijon me fletën tjetër të votimit.

Në rast se gjatë kryerjes së kësaj procedure, për fletën e votimit, vlerësuar e pavlefshme, nuk ka patur kontestime, atëherë ajo vendoset në vendin e caktuar për votat e pavlefshme mbi tavolinën e punës së GNV-së.

#### **VI. Vlerësimi i votave**

Vlerësimi i votave fillon menjëherë pas vlerësimit të fletës së votimit nga faqja e pasme.

Numëruesi i parë, kur vlerëson se vota identifikon qëllimin e votuesit dhe se është votuar qartësisht vetëm për njërin nga kandidatët për kryetar bashkie, e propozon atë për vlerësim tek anëtarët e tjerë të GNV, se për cilin kandidat për kryetar bashkie/subjekt zgjedhor është hedhur vota. Numëruesi i





**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

parë e vendos fletën e votimit në kamerën regjistruese, jo më pak se 4 sekonda, në mënyrë që shenja e cila tregon vullnetin e zgjedhësit, të shikohet qartësisht në monitor dhe bën vlerësimin e votës me zë të lartë. Në rast se anëtarët e Grupit të Numërimit dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore në numërim, janë dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, fleta e votimit ndahet sipas vlerësimit dhe vendoset në vendin e caktuar. Numëruesi i parë merr fletën tjetër të votimit dhe ndjek të njëjtën procedurë.

**VII. Kontestimi dhe rivlerësimi i votës**

Kontestimi i votës bëhet nga anëtarët e GNV ose çdo vëzhgues i subjekteve zgjedhore i tavolinës përkatëse të numërimit duke ngritur dorën e duke thënë “Nuk jam dakord”.

Numëruesi i parë, e vendos fletën e votimit të kontestuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara dhe vijon me fletën tjetër të votimit. Në përfundim të vlerësimit të fletëve të votimit të kutisë përkatëse të votimit, GNV rivlerëson fletët e votimit të kontestuara, por gjatë këtij procesi, fleta e votimit e kontestuar nuk shfaqet më në kamera.

Në rast se edhe pas rivlerësimit, mbeten ende fletë votimi të kontestuara, secili anëtar i GNV ka të drejtë të thërrasë KZAZ-në për vlerësimin e fletëve të votimit të kontestuara të asaj kutie. Vlerësimi i votës bëhet menjëherë nga KZAZ e cila merr vendimin për votë të vlefshme ose të pavlefshme. Sekretari i KZAZ shënon rezultatin e shpallur, nga KZAZ, në Librin e Protokollit të Mbledhjeve i cili përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton Grupi i Numërimit të Votave.

Për secilën fletë të kontestuar, numëruesi i parë i Grupit të Numërimit shënon në pjesën e prapme të saj, qartë, arsyet e kontestimit. Numri i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara për QV–në përkatëse, shënohet nga GNV në Procesverbalin përkatës miratuar me vendim të KQZ-së.

Në përfundim të nxjerrjes së rezultatit për QV përkatëse, fletët e votimit të cilësuar si të kontestuara dhe procesverbali përkatës futen në zarfin e “Fletë votimi të kontestuara”.

**3.6 Hapja e kutisë së materialeve të votimit**

**I. Rrethanat që cojnë në hapjen e kutisë së materialeve të votimit**

Nëse në kutinë e votimit, procesverbali i mbylljes së Votimit mungon ose ky procesverbal nuk është plotësuar saktë, GNV apo vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, pa lëvizur nga vendi, njofton menjëherë KZAZ-në për problemin, duke ngritur dorën.

Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV, derisa KZAZ-ja të marrë vendim për vazhdimin e procedurave të verifikimit të materialit të votimit dhe pezullimin e numërimit të votave nga Grupi i Numërimit. Vendimi i marrë nga KZAZ-ja i bëhet i ditur menjëherë GNV.

Pas njohjes me vendimin e KZAZ-së, numëruesi i parë vendos kutinë me fletët e votimit, numërimi i së cilës është pezulluar, pranë tavolinës së numërimit dhe merr kutinë e materialeve të votimit të qendrës së votimit përkatëse.

**II. Veprimet me kutinë e materialeve të votimit**

Numëruesi i parë, fillon duke këputur vulat me kodet e sigurisë të kutisë së materialeve të votimit. GNV, si fillim, verifikon nëse në kutinë e materialeve të votimit ndodhet procesverbali për Mbylljen e Votimit, i plotësuar në mënyrë të rregullt.



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

**A. Procesverbali për mbylljen e votimit gjendet në kutinë e materialeve të votimit**

GNV ia dorëzon atë KZAZ, e cila pasqyron faktin në Procesverbalin e Konstatimit.

Sekretari i Grupit të Numërimit shënon numrat e kodeve për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit, në procesverbalin e Grupit të Numërimit që përdoret në këtë procedurë, e fut atë në kutinë e materialeve të votimit, dhe kopje të tij ia dorëzon KZAZ-së.

Numëruesi i parë i Grupit të Numërimit mbyll kutinë e materialeve të votimit me vulat me kode sigurie. Numëruesi i parë vendos kutinë e materialeve të votimit pranë tavolinës së numërimit dhe merr kutinë e votimit të qendrës së votimit përkatëse, numërimi i së cilës ishte pezulluar. GNV-ja vazhdon me numërimin e votave sipas procedurave të rregullta për numërimin e tyre.

**B. Procesverbali për mbylljen e votimit nuk gjendet në kutinë e materialeve të votimit**

Nëse procesverbali për mbylljen e votimit nuk gjendet as në kutinë e materialeve të votimit apo nuk është i plotësuar saktë në të gjitha rubrikat e tij, GNV verifikon në kutinë e materialeve të votimit të gjithë dokumentacionin e ndodhur në të .

Numëruesi i parë vijon me numërimin e fletëve të votimit të papërdorura, të dëmtuara.

Numëruesi i parë numëron edhe numrin e zgjedhësve që kanë votuar.

Numëruesi i parë në fund të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin. Gjithashtu ai hedh të dhënat në tabelën për qendrën e votimit. Në këtë tabelë, numëruesi i parë hedh të dhënat për numrin e zgjedhësve që kanë votuar, për fletët e votimit të papërdorura si dhe për fletët e votimit të dëmtuara.

Sekretari i Grupit të Numërimit, në “Procesverbalin e Mbylljes së Kutisë së Materialeve të Votimit” shënon numrat e kodeve dhe e fut atë në këtë kuti, ndërsa numëruesi i parë mbyll kutinë e Materialeve të Votimit me vulat me kode sigurie.

Kutia e materialeve të votimit vendoset nga numëruesi i parë pranë tavolinës së numërimit dhe ai merr kutinë e votimit të qendrës së votimit përkatëse, numërimi i së cilës ishte pezulluar. GNV vazhdon me numërimin e votave, sipas procedurave të rregullta për numërimin e votave.

### **3.7 Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga GNV për qendrën e votimit**

**I. Plotësimi i tabelës së rezultateve**

Në përfundim të procedurave të numërimit dhe vlerësimit të votave për qendrën e votimit, numëruesi i parë së bashku me anëtarët e Grupit të Numërimit, plotësojnë tabelën e rezultateve të kësaj QV-je, për secilin nga kandidatët për kryetar bashkie sipas modelit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave, janë të detyruar të nënshkruajnë tabelën e rezultateve të QV-së, votat e së cilës i kanë numëruar.

Në rast se anëtarët e GNV-së kanë kundërshtime për rezultatet e pasqyruara në tabelë, bëjnë shënime në rubrikën përkatëse të tabelës së rezultateve të Grupit të Numërimit. Tabela e rezultateve,



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

e plotësuar nga anëtarët e Grupit të Numërimit, duke përfshirë dhe kundërshtimet, nëse ka, shfaqet në kamera për jo më pak se 4 (katër) sekonda dhe i dorëzohet menjëherë dorazi KZAZ-së.

Pas plotësimit të Tabelës së Rezultateve të çdo QV-je, KZAZ-ja dërgon elektronikisht, nëpërmjet sistemit në KQZ, informacionin për rezultatin e zgjedhjeve të asaj QV-je.

**II. Dërgimi i rezultateve për çdo qendër votimi në KQZ nga KZAZ**

KZAZ dërgon në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin për rezultatet e zgjedhjeve menjëherë pas marrjes së tabelës së rezultateve nga GNV. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit të numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GNV.

Një kopje e tabelës së rezultatit të GNV, e vulosur me vulën e KZAZ, afishohet nga sekretari i KZAZ-së, në vendin e caktuar në VNV për këtë qëllim.

**III. Mbyllja e kutisë me fletët e votimit**

Pas nxjerrjes së rezultatit dhe plotësimit të tabelës së rezultateve të QV-së nga GNV-ja, fletët e votimit, votat e pavlefshme, fletët e votimit të kontestuara futen në zarfet përkatëse dhe të gjitha futen në kutinë e votimit së bashku me zarfin me procesverbalin për Hapjen e Votimit, zarfin me Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, dhe zarfin me Procesverbalin e Vulosjes. Kutia e votimit mbyllet me vula me kode sigurie të reja. Kopje e procesverbalit të vulosjes i dorëzohet sekretarit të KZAZ-së, i cili përgjigjet për administrimin e tyre si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

Grupi i Numërimit merr nga stiva e kutive të votimit, kutitë me fletët e votimit të qendrës tjetër të votimit, vetëm pasi ka dërguar në vendin e caktuar brenda sallës së Vendit të Numërimit të Votave, kutinë e përpunuar dhe i ka dorëzuar KZAZ-së tabelat e rezultateve të asaj Qendre Votimi.

**3.8 Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ**

Menjëherë pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha QV-ve dhe hedhjes e transmetimit elektronik të rezultateve për çdo qendër votimi në KQZ, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për kryetar bashkie për ZAZ-në Kukës.

**4. MATJA E REZULTATEVE TË TRAJNIMIT**

Vlerësimi do të bëhet nëpërmjet vlerësimit të angazhimit të komisionerëve në temat dhe kazuset, intervistimi dhe trajtimi i problematikave nëpërmjet rasteve ilustruese.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

Sektori i Dokumentacionit Zgjedhor dhe Trajnimeve

# PROGRAMI I TEMAVE TË TRAJNIMIT

“PËR ANËTARËT E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT”



ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS

24 SHTATOR 2023





**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE  
Sektori i Dokumentacionit Zgjedhor dhe Trajnimeve

**PROGRAM I TEMAVE TË TRAJNIMIT**

**“PËR ANËTARËT E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT”**

ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023

**I. TË PËRGJITHËSHME**

<b>Emërtimi i programit të temave të trajnimit</b>	<b>Trajnim i KQV</b>
Target grupi që trajnohet	Anëtarët dhe sekretari i KQV
Numri i pjesëmarrësve që do të trajnohen	518
Lloji i trajnimit	I drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja e trajnimit	3 Orë
Struktura propozuese	Drejtorja e Administratës Zgjedhore
Periudha e trajnimit	20-23 Shtator 2023
Vendi i zhvillimit të trajnimit	Bashkia Kukës, ambiente publike
Struktura që zhvillon trajnimin	Drejtorja e Administratës Zgjedhore



## **II. TË DHËNA MBI PROGRAMIN**

1. OBJEKTIVAT .....	3
2. PROFILI I ANËTARËVE TË TARGET GRUPIT QË TRAJNOHET.....	3
3. TEMAT PËR TRAJNIM .....	3
3.1 Parimet e përgjithshme të zgjedhjeve dhe rregullat e etikës .....	3
3.2 Aplikacioni KQZ, përdorimi dhe raportimi .....	3
3.3 Përbërja e KQV .....	13
3.4 Rastet e shkarkimit, lirimit apo dorëheqjes në KQV .....	14
3.5 Trajtimi i vakancave në KQV .....	14
3.6 Detyrat e Komisionit të Qendrës së Votimit .....	14
3.7 Mbledhjet dhe vendimet e KQV .....	15
3.8 Dokumentacioni i KQV dhe vulat .....	15
3.9 Veprimtaria e KQV një ditë para zgjedhjeve.....	15
3.10 Veprimtaria e KQV në ditën e votimit.....	16
1. Veprimet paraprake .....	16
2. Veprimet paraprake të KQV për hapjen e votimit .....	16
3. Procedura e votimit .....	17
4. Veprimet e KQV kur PEI nuk punon .....	17
5. Mbyllja e votimit .....	18
6. Veprimet pas mbylljes së votimit.....	18
3.11 Rregulla në qendrën e votimit .....	19
3.12 Raste të veçanta të votimit .....	19
3.13 Veprimet që çënojnë procesin e votimit .....	19
4. MATJA E REZULTATEVE TË TRAJNIMIT.....	20



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

## 1. OBJEKTIVAT

Njohja e anëtarëve të KQV me detyrat para, gjatë dhe pas ditës së votimit.

## 2. PROFILI I ANËTARËVE TË TARGETGRUPIT QË TRAJNOHET

Anëtarët e KQV duhet të gëzojnë të drejtën për të qenë zgjedhës e të jenë me vendbanim në zonën përkatëse zgjedhore si dhe të kenë të paktën arsimin e mesëm. Sekretari i KQV duhet të jetë me profesion jurist.

## 3. TEMAT PËR TRAJNIM

### 3.1 Parimet e përgjithshme të zgjedhjeve dhe rregullat e etikës

Në këtë temë do të trajtohen rregullat e etikës, njohja e tyre dhe domosdoshmëria e zbatimit të tyre si ligjshmëria, transparenca, kolegjaliteti, paanësia, pavarësia dhe objektiviteti.

### 3.2 Mjetet e komunikimit me KQZ-në

KQZ vendos në ndihmë të administratës zgjedhore (komisionerëve të qendrave të votimit) këto mjete komunikimi:

- Aplikacionin KQZ i shkarkueshëm në aparatët telefonikë me system operativ Android ose IOS
- Numrin e telefonit pa pagesë 08000803
- Komunikimi me Telegram dhe Whatsapp në numrin e telefonit 0694003032

#### 1. Aplikacioni KQZ, përdorimi dhe raportimi

Simulohet regjistrimi i sekretarëve apo çdo anëtar të KQV me aplikacionin KQZ. Demonstronhet nëpërmjet përdorimit aksesimi në sistem, krijimi i llogarisë dhe raportimi në kohë reale, për ecurinë apo problematikat e shfaqura në procesin e votimit dhe raportimi çdo orë nëpërmjet aplikacionit. Ndërveprimi i KQV-së me operatorin PEI, kërkesa për të skanuar me QR Code pjesëmarrjen çdo orë.

Aplikacioni KQZ shërben si një platformë elektronike e komunikimit midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe KZAZ e KQV.

Nëpërmjet këtij aplikacioni secili prej anëtarëve, apo sekretarëve të këtyre komisioneve ka mundësinë të dërgojë informacione, apo raporte në KQZ në kohë reale në lidhje me procesin zgjedhor, përfshi këtu edhe ditën e votimit e më pas.

Aplikacioni ofron mundësinë që çdo anëtar, apo sekretar i këtyre komisioneve të informojë dhe të raportojë individualisht dhe i pa kushtëzuar nga kolegët e tjerë të komisionit përkatës.

Për këtë qëllim, secili prej anëtarëve apo sekretarëve krijon një llogari (profil) të vetin në këtë aplikacion.



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

Pasi keni krijuar një llogari tuajën (anëtar, apo sekretar KZAZ/KQV) ju mundet të hyni në të dhe plotësoni fushat përkatëse sipas rastit.

Plotësimi i tyre është shumë i thjeshtë, pasi ju duhet vetëm t’ju përgjigjeni pyetjeve përkatëse duke klikuar në fushat përkatëse.

### **A. KRIJIMI I LLOGARISË**

Llogaria krijohet nëpërmjet kësaj procedure:

- 1) Hyr në aplikacionin KQZ në telefonin celular, ose në tableta;
- 2) Kliko në fund të ekranit të telefonit, djathtas ku është butoni “Komisioner” (shiko figurën 1.1).



- 3) Në ekran shfaqet pamja (si në figurën 1.2 më poshtë)





**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*




Figura 1.2

- 4) Shtyp butonin “Regjistrohu”; ( si ne figurën 1.3)




Figura 1.3

- 5) Në ekran shfaqet pamja (si në fig. 2)




Figura 2

- 6) Vendosni numrin tuaj personal sipas kartës së identitetit dhe numrin tuaj të telefonit (si në figurën 3)



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

**REGJISTROHU NË ZONËN KQZ/KZAZ:**

NID  
AXXXXXXXXO 10/10

Telefon  
+355068XXXXXX 4 8/8

REGJISTROHU

Figura 3

7) Sigurohu që keni vendosur të dhënat e sakta dhe kliko “Regjistrohu” (shih Figura 4)

8/8

REGJISTROHU

Figura 4

8. Pas klikimit, të dhënat tuaja janë dërguar në sistemin e bazës së të dhënave në KQZ ku bëhet verifikimi automatik i tyre. Nëse ju jeni anëtar, apo sekretar i KZAZ, apo KQV, sistemi krijon llogarinë tuaj dhe ju dërgon në telefon një SMS e cila përmban fjalëkalimin për të hyrë në llogarinë tuaj (siç tregohet në figurën 5).



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*




Figura 5

9. Në aparatin tuaj të telefonit ju do të njoftoheni me një mesazh për regjistrimin në aplikacionin KQZ (si në figurën 6)



10. Mbani shënim fjalëkalimin i cili ju nevojitet për të hyrë në sistem.

### **B. HYRJA NË LLOGARI**

1. Pasi ke hyrë në aplikacionin KQZ, kliko në fund të ekranit të telefonit, djathtas ku është butoni “Komisioner” (shiko figurën 7).



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*



Figura 7

2. Në ekran shfaqet pamja (si në figurën 8)




Figura 8

3. Vendos numrin personal të Identifikimit në fushën përkatëse si në figurën 9.




Figura 9

4. Vendos fjalëkalimin që është dërguar me SMS si në figurën 10



Figura 10

5. Shtyp butonin HYR (shiko figurën 11)



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*




Figura 11

6. Pasi keni shtypur HYR do ju shfaqet në ekran kjo dritare me këtë përmbajtje (duke specifikuar emrin, pozicionin, datën e orën) si në figurën 12





Figura 12


7. Në rastin kur duhet të raportosh kliko (shtyp) butonin “Raporto” si në figurën 13



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*



8. Ditën e votimit Sekretari do të plotësojë pyetësorin duke zgjedhur njërën prej opsioneve të kërkuara





## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

### KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

#### Figura 14.4

##### RAPORTIM NË DITËN E VOTIMIT

Shëno numrin e zgjedhësve që kanë votuar

Procesi i votimit është:

1) Normal

2) Me probleme

3) I bllokuar

Procesi i votimit ka filluar në:

1) Ora 07:00

2) Ora 07:30

3) Ora 08:30

Home Raportimet Qr Scan Dalje

#### Figura 14.5

2) Lista e Zgjedhësve

3) Boja Matrikulluese

4) Vula e KQV-se

Keni marrë në dorëzim kamerën e vëzhgimit? Po  Jo

Keni marrë në dorëzim PEI (Pajisjen Elektronike të Identifikimi)? Po  Jo

Numri i kutive të votimit që keni marrë në dorëzim

1) 1 kuti

2) 2 kuti

Home Raportimet Qr Scan Dalje

#### Figura 14.6

Shëno kodet e sigurisë me të cilat është mbyllur kutia e votimit për këshillin e bashkisë:

1)

2)

3)

4)

5)

Shëno kodet e sigurisë me të cilat është mbyllur kutia e votimit për kryetar të bashkisë:

1)

2)

3)

Home Raportimet Qr Scan Dalje

#### Figura 14.7

1) Ora 07:00

2) Ora 07:30

3) Ora 08:30

4) Ora 09:00

5) Pas orës 09:00

Keni marrë vendim për hapjen e QV në ora 07:00? Po  Jo

Materialet zgjedhore që mungojnë :

1) Fletët e votimit

2) Lista e Zgjedhësve

3) Boja Matrikulluese

Home Raportimet Qr Scan Dalje

#### Figura 14.8

Numri i kutive të votimit që keni marrë në dorëzim

1) 1 kuti

2) 2 kuti

Është paraqitur Operatori i PEI në qendrën e votimit? Po  Jo

Raporto problematikat e hasura:

Shëno kodet e sigurisë me të cilat është mbyllur kutia e votimit për këshillin e bashkisë:

1)

Home Raportimet Qr Scan Dalje

#### Figura 14.9

3)

4)

5)

Shëno numrin e zgjedhësve që morën pjesë në zgjedhje:

Shëno orën e mbylljes së votimit:

1) Ora 19:00

2) Ora 19:30

3) Ora 20:00

Morët vendim për mbylljen e votimit në orën Po  Jo

Home Raportimet Qr Scan Dalje



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

**Figura 14.10**

Morët vendim për mbylljen e votimit në orën 19:00? Po  Jo

Si është situata në qendrën e votimit?

1) Normale

2) Tensionuar

3) Bllokuar (pezulluar)

Procesi i votimit ka filluar në:

1) Ora 07:00

2) Ora 07:30

3) Ora 08:30

Home Raportimet Qr Scan Dalje

**Figura 14.11**

Procesi i votimit ka filluar në:

1) Ora 07:00

2) Ora 07:30

3) Ora 08:30

4) Pas orës 09:00 /më vonë

Është pajisja PEI dhe kamera funksionale duke u përdorur nga operatori? Po  Jo

Keni marrë vendim për hapjen e QV në orën 07:00? Po  Jo

Keni marrë në dorëzim të

Home Raportimet Qr Scan Dalje

**Figura 14.12**

3) Ora 08:30

4) Pas orës 09:00 /më vonë

Është pajisja PEI dhe kamera funksionale duke u përdorur nga operatori? Po  Jo

Keni marrë vendim për hapjen e QV në orën 07:00? Po  Jo

Keni marrë në dorëzim të gjithë materialet zgjedhore? Po  Jo

**> Dërgo Raportimin**

Home Raportimet Qr Scan Dalje

9. Pasi keni plotësuar një të një prej pyetjeve apo të gjitha pyetjet shtyp butonin “Dërgo raportimin” si në figurën 15



10. Nëse jeni anëtar ju do t’ju shfaqet për plotësim vetëm hapësira raporto problematikat e hasura (si në figurën 16.1) dhe si është situata në qendrën tuaj të votimit (si në figurën 16.2) dhe pasi keni raportuar shtyp butonin “Dërgo raportimin” si në figurën 15 më sipër).

**Figura 16.1**

Raporto problematikat e hasura:

**Figura 16.2**

Si është situata në qendrën e votimit?

1) Normale

2) Tensionuar


3) Bllokuar (pezulluar)

11. Në rastin kur Sekretari do të ngarkojë dokument (foto vendimi/ procesverbali hapje/ mbyllje) kliko butonin “Ngarko Dokumentacion” si në figurën 17





**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*



12. Nëpërmjet kamerës së aparatit do të ngarkoni fotografinë dhe do të dërgoni raportimin tuaj.
13. Kryetar, Sekretar dhe çdo anëtar, KUJTO Operatorin e PEI që të skanojë çdo orë Kodin QR që printon pajisja PEI për raportimin e pjesëmarrjes.
14. Çdo anëtar i KQV-së mund të denoncoje shkelje të ligjit nga subjektet, anëtarët e tjerë të komisionit apo nga zgjedhësit nëpërmjet këtij aplikacioni.

## 2. Ndërplatformat Whatsapp dhe Telegram

KQZ për t’ju ardhur në ndihmë anëtarëve të KQV-së vendos në dispozicion numrin e celularit 0694003032 për të komunikuar në platformat Whatsapp dhe Telegram.

Çdo anëtar i KZAZ-së ftohet me lidhjen përkatëse që të bëhet pjesë e grupit. Për t’u bërë pjesë e grupit anëtari i KZAZ-së mund të skanojë nga aparati i tij telefonik kodin QR në Whastapp dhe Telegram si më poshtë:



WhatsApp 1



Telegram 1

Këto mjete komunikimi shërbejnë për të marrë udhëzime & informacione në kohë reale nga KQZ. Çdo anëtar i KQV-së apo subjekt i interesuar mund të telefonojë pa pagesë në numrin 08000803.

### 3.3 Përbërja e KQV

Në këtë temë do të trajtohen përbërja e KQV dhe balanca politike si dhe kushtet për të qenë anëtar i KQV. KQV përbëhet nga 7 anëtarë ku njëri prej tyre ushtron detyrën e sekretarit. Anëtarët e KQV emërohen nga KZAZ, pas propozimeve të partive politike. Për t’u emëruar anëtar i KQV duhet që ai të



## **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

### **KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

gëzojë të drejtën për të qenë zgjedhës, të jetë me vendbanim në zonën përkatëse zgjedhore, të ketë së paku arsimin e mesëm, përveç sekretarit i cili duhet të jetë si rregull me arsim të lartë. Gjithashtu ai nuk duhet të jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore në proceset e mëparshme zgjedhore. Anëtari dhe sekretari i KQV-së nuk mund të jetë deputet, kandidat ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore, ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror apo anëtar, sekretar i një komisioni tjetër zgjedhor.

#### **3.4 Rastet e shkarkimit, lirimit apo dorëheqjes në KQV**

KZAZ, me vendim mund të shkarkojë anëtarin apo sekretarin e KQV-së. Anëtarët dhe sekretari i KQV shkarkohen nga detyra, kur shkelin dispozitat e Kodit Zgjedhor ose të akteve nënligjore në zbatim të tij apo kur dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Një shkak tjetër i shkarkimit është edhe kur anëtari apo sekretari i KQV nuk paraqiten në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht ose kur nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ. Kur ata shkarkohen, nuk mund të rizgjidhen më në këtë detyrë. Lirimi nga detyra ndodh kur anëtari i KQV është në kushte të konfliktit të interesit (krushqie apo marrëdhënie pune) me kandidatin për kryetar të bashkisë. Në rastin e dorëheqjes, deklarata e dorëheqjes depozitohet në KQV dhe sekretari njofton menjëherë KZAZ. Anëtari i KQV-së i liruar apo i dorëhequr, nuk largohet nga detyra, pa e dorëzuar atë tek zëvendësuesi i tij.

#### **3.5 Trajtimi i vakancave në KQV**

Në ditën e zgjedhjeve, mungesa e anëtarit/ëve një orë para hapjes së votimit ose largimit gjatë ditës së votimit njoftohet menjëherë në KZAZ nga cilido anëtar i KQV. Në rast se shkarkohet, lirohet apo dorëhiqet nga detyra sekretari i KQV-së, procedurat vijohet nga një anëtar i KQV me të njëjtën përkatësi politike. Kuorumi për veprimtarinë e KQV-së është 4 anëtarë. Në rast të mungesës së kuoromit, 24 orë para hapjes së procesit të votimit ose në ditën e zgjedhjeve, KQV vazhdon detyrën, vetëm pas urdhërimit të KZAZ. Sekretari dokumenton, regjistron dhe shënon në librin e protokollit të mbledhjeve të gjitha detajet e njoftimit të vakancës nga KQV dhe orën e komunikimit të urdhërimit të KZAZ për vijimin e procedurave, pavarësisht kuoromit.

#### **3.6 Detyrat e Komisionit të qendrës së votimit**

Kryetari i KQV drejton veprimtarinë e KQV, që nga dita e ngritjes së saj. Ai ka detyrimin të angazhohet në marrjen e materialeve zgjedhore dhe teknologjisë përkatëse për fillimin e procesit të votimit në QV, ndjekjen e ecurisë së procesit të votimit me identifikimin e zgjedhësve, listën e zgjedhësve, vulosjen e fletës së votimit me Vulën e Kryetarit të QV, mbylljen e procesit të votimit si dhe drejton mbledhjet e KQV. Pra, në tërësi, ai është përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në QV.



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

Detyra e sekretarit lidhet me administrimin e të gjithë dokumentacionit ligjor, ku bazohet puna e KQV. Puna e tij konsiston në marrjen e materialeve zgjedhore së bashku me kryetarin e KQV, administrimin e vulës së QV, vulosjen e fletëve të votimit me vulën e QV dhe procesverbaleve e vendimeve të KQV. Ai përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në kutinë e materialeve të votimit dhe vulosjen e saj me vulat me kodet e sigurisë. Sekretari administron Librin e Protokollit të Mbledhjeve si dhe regjistron marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KZAZ, vendimet e KQV, vërejtjet e vëzhguesve. Edhe regjistri i posaçëm administrohet prej tij. Ai mban kontakte me KZAZ, me KQZ dhe me operatorin e pajisjes PEI dhe të kameras.

Anëtarët e KQV janë përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në QV dhe zbatojnë detyrat e përcaktuara me Vendim të KQV në funksion të mbarëvajtjes së zgjedhjeve në QV.

### 3.7 Mbledhjet dhe vendimet e KQV

Mbledhjet e KQV-së janë publike. Vendimet e KQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Të vlefshme janë edhe vendimet e KQV-së, që kryen detyrat nën kuorum, pas urdhërimit nga KZAZ. Në rastet se KQV nuk arrin të marrë vendim, çështja i dërgohet menjëherë për shqyrtim KZAZ-së nga kryetari ose nga të paktën dy anëtarë të KQV-së. Vendimi i KZAZ-së zbatohet nga KQV-ja.

KQV merr vetë vendimin për të vijuar votimin pa identifikim elektronik në rast se pajisja PEI nuk është riparuar apo zëvendësuar. Ky vendim merret vetëm pasi kalojnë 3 orë nga koha e njoftimit të asistencës teknike.

### 3.8 Dokumentacioni i KQV dhe vulat

Kjo çështje trajton dokumentacionin e punës së KQV si librin e protokollit të mbledhjeve apo regjistrin e posaçëm të zgjedhëse. Gjithashtu trajtohen llojet e procesverbaleve që plotësohen nga KQV në ditën e zgjedhjeve. Shpërndahen modelet e miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

### 3.9 Veprimtaria e KQV një ditë para zgjedhjeve

- a. Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore. Kryetari dhe sekretari i KQV, një ditë para ditës së zgjedhjeve, jo më vonë se ora 15:00, tërheq nga KZAZ-ja kutinë me materialet zgjedhore, kutinë e votimit, vulat me kodet e sigurisë, listën e zgjedhësve, pajisjen elektronike të identifikimit PEI dhe kamerën. Të gjitha procesverbalet e marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore mbahen në ruajtje nga sekretari i KQV-së. Kryetari merr në dorëzim vulën e kryetarit të QV.
- b. Dërgimi i materialeve zgjedhore në qendrën e votimit.

KQV-ja, materialet e marra në dorëzim, i vendos në qendrën e votimit, të ruajtur nga Policia e Shtetit. Asgjë prej këtyre materialeve nuk nxirren jashtë prej saj. KQV sistemon qendrën e votimit (tavolina,



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

karrige) dhe mbyll dritaret dhe derën. KQV, në asnjë rast, nuk kryen asnjë veprim me pajisjen PEI apo me kameran.

c. Mbyllja me etiketa sigurie e QV-se plotësimi i procesverbalit me Policinë.

KQV, pasi mbyll derën dhe vendos etiketën e sigurisë në të e dorëzon Qendrën e Votimit te punonjësi i policisë. Ky veprim dokumentohet përmes “Procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit një ditë para ditës së zgjedhjeve me etiketën e sigurisë”.

### 3.10 Veprimtaria e KQV në ditën e votimit

#### 3. Veprimet paraprake

- a. KQV dhe operatori paraqitet në QV në orën 6:00 dhe merr në dorëzim QV nga Policia e Shtetit.
- b. Veprimi i parë është vendosja në funksion e kamerës në mënyrë që të shihet e gjithë veprimtaria në KQV duke mos cenuar fshehtësinë votës. Procesi i regjistrimit fillon që në orën 6:00 dhe vijon pandërprerë derisa KQV me kutitë e votimit dhe atë të materialeve zgjedhore largohen nga qendra e votimit
- c. KQV organizon qendrën e votimit (tryeza, karrige, dhomat e fshehta, vendin e vëzhguesve, afishimin e materialeve propagandistike që kanë marrë nga KZAZ, flamurin kombëtar, tabelën treguese për numrin e KZAZ, numrin e QV dhe orarin e votimit).
- d. heq materialet propagandistike që mund të ndodhen në QV ose rreth saj në një rreze prej 150 m;
- e. afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të dukshëm brenda qendrës së votimit;
- f. I dorëzon operatorit pajisjen PEI. Ky veprim dokumentohet me plotësimin e procesverbalit KQV-Operator “Për dorëzimin e pajisjes PEI”.
- g. Operatori i pajisur me badge dhe jelek, vë në funksion pajisjen elektronike të identifikimit PEI. Operatori ulet ndërmjet kryetarit dhe sekretarit të KQV. Pajisja përdoret vetëm nga operatori. Në asnjë rast anëtarët e KQV-se nuk përdorin pajisjen.

#### 4. Veprimet paraprake të KQV për hapjen e votimit

- a. Sekretari kontrollon/ inventarizon të gjitha materialet zgjedhore sipas procesverbaleve të cilat i disponojnë nga KZAZ .
- b. KQV merr vendim për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV-së, sipas modelit të vendimit “Për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV”, miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
- c. U tregon vëzhguesve kutinë e votimit, të zbrazët.
- d. Vulos kutitë e votimit me katër vula me kode sigurie në mënyrë të tillë, që të mos lejojë hapësira mes kutive dhe kapakut të tyre, dhe plotëson modelin e procesverbalit



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

të vulosjes së kutive të votimit. Në rast se ndonjë nga vulat me kodet e sigurisë dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë së votimit, ajo zëvendësohet me një nga vulat rezervë. Në librin e protokollit dhe në procesverbalin e vulosjes shënohet numri i kodit të sigurisë së dëmtuar dhe ai i vulës shtesë.

- e. Konfirmon, pas aktivizimit të pajisjes PEI nga operatori teknik, numrin e qendrës së votimit, vendodhjen e saj si dhe numrin e zgjedhësve në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit.
- f. Verifikon nëse informacioni që shfaqet në ekranin e pajisjes PEI është i njëjtë me të dhënat e QV. Nëse këto të dhëna janë të njëjta, autorizon operatorin të vijojë konfigurimin e pajisjes PEI.
- g. Pajisja PEI printon raportin e hapjes të procesit të identifikimit elektronik, ku numri i zgjedhësve identifikuar elektronikisht duhet të jetë 0. Ky raport nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së dhe vuloset me vulën e KQV-së. Raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik futet në kutinë e materialeve të votimit.
- h. Sekretari fut në kutinë e votimit për kryetar të bashkisë, para fillimit të procesit të votimit, zarfin e etiketuar “Zarfi i procesverbalit të vulosjes”, në të cilin futet origjinali i procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KQV-së, të vulosur nga sekretari dhe mbyllur prej tij. Dy kopje të tjera të këtij procesverbali, pasi janë mbyllur në zarfin “Zarfi i procesverbalit të vulosjes” futen respektivisht një në kutinë për këshillin e bashkisë, edhe një në kutinë e materialeve të votimit.
- i. Marrin vendimin për hapjen e votimit, sipas modelit të vendimit “Për hapjen e votimit”.
- j. Përmes kryetarit, deklarojnë hapjen e votimit jo më parë se ora 7.00.

#### **5. Procedura e votimit**

Zgjedhësi paraqitet para KQV dhe i paraqet dokumentin e identifikimit kryetarit të KQV, i cili kryen verifikimin fizik të mbajtësit të dokumentit dhe fotos në dokumentin e ID. Këtë dokument ia kalon më pas operatorit PEI. Të dhënat e zgjedhësit shfaqen në ekran, përfshirë dhe foto. Anëtarët e KQV kanë mundësinë të verifikojnë në ekranin e pajisjes të dhënat e zgjedhësit, përfshirë edhe foton. Më pas zgjedhësi që është në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi, nënshkruan biometrikisht në pajisje. Dokumenti që printohet përbën material zgjedhor dhe futet në një zarf të posaçëm. Në asnjë rast anëtarët e KQV-se nuk duhet të ndajnë me persona të tjerë të pranishëm në QV (vëzhgues) numrin rendor të tij. Secili nga anëtarët e KQV kryen detyrën që i është caktuar në momentin e ndarjeve të detyrave.

#### **6. Veprimet e KQV kur PEI nuk punon**

PEI ka defekt dhe nuk realizohet riparimi apo zëvendësimi brenda 3 orësh. KQV merr vendimin për të kaluar tek identifikimi tradicional i zgjedhësve me listë të printuar zgjedhësish. Çdo vendim i marrë nga KQV, pa kaluar ky afat ose pa pasur një vendimarrje



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

nga KQZ për kalimin e identifikimit të zgjedhësve me listë fizike zgjedhësish, është i paligjshëm.

### **7. Mbyllja e votimit**

Votimi mbyllet në orën 19:00. Pas kësaj ore, mund të votojnë vetëm zgjedhësit të cilët në orën 19.00 janë gjendur në radhë, në qendrën e votimit, për të votuar. Një nga anëtarët e KQV mbledh dokumentet e identifikimit të zgjedhësve dhe i thërret me radhë ata për të kryer votimin. Votimi mbyllet pasi voton edhe zgjedhësi i fundit, i pranishëm. Votojnë të fundit: Anëtarët e KQV-së; Operatori teknik i QV-së/personi i ngarkuar për funksionimin e kamerës, nëse nuk është zgjedhës në atë qendër votimit dhe është zgjedhës i zonës zgjedhore.

KQV-ja merr vendim për mbylljen e votimit.

Operatori teknik mbyll procesin e identifikimit elektronik të zgjedhësve. PEI printon raportin e mbylljes, i cili nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së, vuloset nga sekretari dhe administrohet nga kryetari dhe pajisja PEI mbyllet në valixhe me vulë me kod sigurie. Kjo procedurë dokumentohet me plotësimin e procesverbalit KQV-Operator “Për dorëzimin e pajisjes PEI”.

Kryetari deklaron me zë të lartë të dhënat për zgjedhësit që kanë votuar, dhe urdhëron sekretarin të plotësojë, në të gjitha rubrikat, procesverbalin për mbylljen e votimit.

### **8. Veprimet pas mbylljes së votimit**

Kryetari nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura dhe deklaron shifrën. Nëse kërkohet rinumërimi nga ndonjë anëtar i KQV apo vëzhgues, ai rifillon sërish. Ky numër pasqyrohet në procesverbalin e mbylljes së votimit, në librin e protokollit të mbledhjeve dhe këto fletë votimi futen në zarfin e fletëve të votimit të papërdorura. E njëjta procedurë ndiqet edhe për numërimin e fletëve të dëmtuara

I gjithë materiali zgjedhor futen në kutinë e materialeve zgjedhore.

Numri i kodeve të sigurisë, me të cilët do të mbyllet kutia/itë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, shënohen paraprakisht në “Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në “Librin e Protokollit të Mbledhjeve” të KQV-së. Originali i “Procesverbalit për Mbylljen e Votimit” futet në kutinë e votimit për kryetar bashkie, e cila vuloset menjëherë me kodin e pestë të sigurisë. Kopje të procesverbalit të mbylljes së votimit futet dhe në kutinë e materialeve të votimit.

Kopje të Procesverbalit për Mbylljen e Votimit dhe të raportit të mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve të riprintuar pa përfshirë numrin rendor në listë të zgjedhësve, u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare.



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

Kryetari, sekretari dhe kushdo tjetër anëtar i KQV që dëshiron, të shoqëruar nga punonjësi e policisë dorëzojnë në KZAZ, kutinë e votimit, kutinë e materialeve zgjedhore dhe PEI, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se tre orë nga mbyllja e votimit në QV.

### 3.11 Rregulla në qendrën e votimit

KQV lejon në qendrën e votimit vëzhgues të cilët duhet të jenë domosdoshmërisht të akredituar nga KQZ apo KZAZ. Sekretari i KQV-së u kontrollon vëzhguesve shqiptarë dhe të huaj dokumentin e akreditimit dhe dokumentin e identifikimit të vlefshëm. Komisioni i Qendrës së Votimit duhet t’u mundësojë vëzhguesve vëzhgimin pa pengesë të procesit zgjedhor në të gjitha fazat, por duhet të kujdeset që vëzhguesit të mos bëjnë propagandë e të mos influencojnë në vullnetin e zgjedhësit si dhe të mos ndërhyjnë në procesin e votimit dhe të vendimmarrjes së KQV. Vëzhguesit nuk duhet të shënojnë apo dokumentojnë me çfarëdo mënyre e mjeti, brenda ambienteve të qendrës së votimit të dhëna që mund të çojnë në identifikimin e zgjedhësve që po votojnë, kanë votuar apo do të votojnë.

KQV lejon në QV operatorin teknik të QV-së i emëruar nga KQZ/personin e ngarkuar me detyrë për funksionimin e kamerës në QV si dhe zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit.

Fotografimi i votës, është rreptësisht i ndaluar. KQV nuk lejon përdorimin e telefonave celularë dhe kamerave të çdo lloji nga askush me përjashtim të përdorimit të telefonit celular nga sekretari për komunikimet me KZAZ për hapjen e mbylljen e procesit të votimit si dhe për pjesëmarrjen në votim. KQV lejon filmime të shkurtra jo më shumë se 15 minuta të procesit zgjedhor nga ana e vëzhguesve të medias së akredituar, por pa penguar procesin e votimit dhe pa kompromentuar fshehtësinë e votimit.

### 3.12 Raste të veçanta të votimit

Në këtë temë trajtohen procedurat që ndjek KQV lidhur me zgjedhësin që për arsye fizike nuk mund të votojë vetë, apo të verbrin që mund të votojë vetë apo zgjedhësi që paraqitet me vendim gjykate si dhe raste të tjera kur dokumenti i identiteti nuk lexohet nga pajisja PEI apo kur zgjedhësi nuk pranon të timbrohet me lëndën e posaçme. Nëse PEI punon dhe zgjedhësi identifikohet mjetin e identifikimit në PEI, por nuk mundësohet marrja e gjurmëve të gishtërinjve, atëherë ai duhet të nënshkruajë fizikisht në listën e zgjedhësve si dhe në dokumentin që prodhon PEI.

### 3.13 Veprimet që çënojnë procesin e votimit

Tema trajton votimin për herë të dytë, apo votimi jashtë dhomës së fshehtë, fotografimi i votës, votimi familjar etj.



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”*

#### **4. MATJA E REZULTATEVE TË TRAJNIMIT**

Vleresimi do të bëhet nëpërmjet vlerësimit të angazhimit të komisionerëve në temat dhe kazuset, intervistimi dhe trajtimi i problematikave nëpërmjet rasteve ilustruese.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

Sektori i Dokumentacionit Zgjedhor dhe Trajnimeve

# PROGRAMI I TEMAVE TË TRAJNIMIT

“PËR ANËTARËT E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT  
ZGJEDHOR”



ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS

24 SHTATOR 2023





**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE  
Sektori i Dokumentacionit Zgjedhor dhe Trajnimeve

**PROGRAM I TEMAVE TË TRAJNIMIT**

**“PËR ANËTARËT E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT  
ZGJEDHOR”**

ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023

**I. TË PËRGJITHËSHME**

<b>Emërtimi i programit të temave të trajnimit</b>	<b>Trajnim i KZAZ</b>
Target grupi që trajnohet	Anëtarët dhe sekretari i KZAZ
Numri i pjesëmarrësve që do të trajnohen	8
Lloji i trajnimit	I drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja e trajnimit	4 Orë
Struktura propozuese	Drejtorja e Administratës Zgjedhore
Periudha e trajnimit	9 Shtator 2023
Vendi i zhvillimit të trajnimit	Bashkia Kukës, Selia KZAZ Nr. 11
Struktura që zhvillon trajnimin	Drejtorja e Administratës Zgjedhore



## **II. TË DHËNA MBI PROGRAMIN**

<b>1. OBJEKTIVAT .....</b>	<b>3</b>
<b>2. PROFILI I ANËTARËVE TË TARGETGRUPIT QË TRAJNOHET .....</b>	<b>3</b>
<b>3. TEMAT PËR TRAJNIM .....</b>	<b>3</b>
3.1 Platformat e komunikimit në mbështetje të organizimit të zgjedhjeve .....	3
I. Aplikacioni KQZ .....	3
II. Platforma Microsoft TEAMS .....	9
III. Ndërplatformat Whatsapp dhe Telegram .....	9
3.2 Përbërja e KZAZ, parimet e përgjithshme dhe rregullat e etikës.....	10
3.3 Rastet e shkarkimit, lirimit në KZAZ.....	10
3.4 Trajtimi i vakancave në KQV .....	11
3.5 Detyrat e KZAZ .....	11
3.6 Mbledhjet dhe vendimet e KZAZ .....	11
3.7 Dokumentacioni i punës së KZAZ.....	12
3.8 Regjistrimi i komiteteve nismëtare .....	12
3.9 Regjistrimi i kandidatit për kryetar të bashkisë .....	12
3.10 Detyra të KZAZ për krijimin dhe funksionimin e qendrës së votimit .....	13
3.11 Detyra të KZAZ për organizimin e VNV .....	14
3.12 Detyra të KZAZ për krijimin e grupeve të numërimit të votave.....	14
3.13 Detyra të KZAZ për akreditimin e vëzhguesve .....	14
3.14 Shpërndarja në kohë e materialeve të votimit .....	14
3.15 Marrja në dorëzim e materialeve të votimit.....	15
3.16 Tabelat e rezultateve .....	15
3.17 Dorëzimi i materialeve në KQZ .....	15
3.18 Afishimi i listës së zgjedhësve dhe verifikimi i objekteve zgjedhore .....	13
<b>4. MATJA E REZULTATEVE TË TRAJNIMIT .....</b>	<b>15</b>



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

## 1. OBJEKTIVAT

Njohja e anëtarëve të KZAZ me detyrat para, gjatë dhe pas ditës së votimit.

## 2. PROFILI I ANËTARËVE TË TARGET GRUPIT QË TRAJNOHET

Anëtarët e KZAZ duhet të gëzojnë të drejtën për të qenë zgjedhës e të jenë me vendbanim në zonën përkatëse zgjedhore si dhe të kenë arsimin e lartë. Sekretari i KQV duhet të jetë me profesion jurist.

## 3. TEMAT PËR TRAJNIM

### 3.1 Platformat e komunikimit në mbështetje të organizimit të zgjedhjeve

Në këtë temë do të trajtohen mjetet dhe mënyra e komunikimit ndërmjet KZAZ me KQZ në lidhje me administrimin e dokumentacionit, shkëmbimit të informacionit dhe monitorimin e procesit zgjedhor ditën e zgjedhjeve nga KZAZ/ KQZ.

KQZ vendos në dispozicion të anëtarëve të KZAZ-se mjetet e mëposhtme të komunikimit dhe bashkërendimit të informacionit dhe dokumentacionit: Aplikacioni KQZ, ndër platformën e Komunikimit Whatsapp, Telegram dhe TEAMS si dhe linjat e ndihmës.

#### I. Aplikacioni KQZ

Anëtari i KZAZ-se sapo merr detyrën shkarkon menjëherë aplikacionin KQZ në aparatin e tij/ saj telefonik (smartphone).

Aplikacioni KQZ shërben si një platformë elektronike e komunikimit midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe KZAZ e KQV.

Nëpërmjet këtij aplikacioni secili prej anëtarëve, apo sekretarëve të këtyre komisioneve ka mundësinë të dërgojë informacione, apo raporte në KQZ në kohë reale në lidhje me procesin zgjedhor, përfshi këtu edhe ditën e votimit e më pas.

Aplikacioni ofron mundësinë që çdo anëtar, apo sekretar i këtyre komisioneve të informojë dhe të raportojë individualisht dhe i pa kushtëzuar nga kolegët e tjerë të komisionit përkatës.

Për këtë qëllim secili prej anëtarëve, apo sekretarëve krijon një llogari (profil) të vetin në këtë aplikacion.

Pasi keni krijuar një llogari tuajën (anëtar, apo sekretar KZAZ/KQV) ju mundet të hyni në të dhe plotësoni fushat përkatëse sipas rastit.

Plotësimi i tyre është shumë i thjeshtë, pasi ju duhet vetëm t’ju përgjigjeni pyetjeve përkatëse duke klikuar në fushat përkatëse.

#### A. Krijimi i llogarisë

Llogaria krijohet nëpërmjet kësaj procedure:



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

- 1) Hyr në aplikacionin KQZ në telefonin celular, ose në tableta;
- 2) Kliko në fund të ekranit të telefonit, djathtas ku është butoni “Komisioner” (shiko figurën 1.1).



Figura 1.1

- 3) Në ekran shfaqet pamja (si në figurën 1.2 më poshtë)




Figura 1.2

- 4) Shtyp butonin “Regjistrohu”; ( si ne figurën 1.3)



Figura 1.3

- 5) Në ekran shfaqet pamja (si në fig. 2)



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

REGJISTROHU NË ZONËN KQZ/KZAZ

NID  
📞 NID  
0/10

Telefon  
📞  
0/8

REGJISTROHU

Figura 2

Ku votoj Subjektet Home Qr Scan Komisione...

- 6) Vendosni numrin tuaj personal sipas kartës së identitetit dhe numrin tuaj të telefonit (si në figurën 3)

REGJISTROHU NË ZONËN KQZ/KZAZ

NID  
📞 AXXXXXXXXO  
10/10

Telefon  
📞 +355068XXXXXX 4  
8/8

Figura 3

REGJISTROHU

- 7) Sigurohu që keni vendosur të dhënat e sakta dhe kliko “Regjistrohu” (shih Figura 4)

8/8


Figura 4

REGJISTROHU



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

8. Pas klikimit të dhënat tuaja janë dërguar në sistemin e bazës së të dhënave në KQZ ku bëhet verifikimi automatik i tyre. Nëse ju jeni anëtar, apo sekretar i KZAZ, sistemi krijon llogarinë tuaj dhe ju dërgon në telefon një SMS e cila përmban fjalëkalimin për të hyrë në llogarinë tuaj (siç tregohet në figurën 5).



9. Në aparatit tuaj të telefonit ju do të njoftoheni me një mesazh për regjistrimin në aplikacionin KQZ (si në figurën 6)



10. Mbani shënim fjalëkalimin i cili ju nevojitet për të hyrë në sistem.

*B. Hyrja në llogari dhe raportimi*



## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”

1. Pasi ke hyrë në aplikacionin KQZ, kliko në fund të ekranit të telefonit, djathtas ku është butoni “Komisioner” (shiko figurën 7).



Figura 7

2. Në ekran shfaqet pamja (si në figurën 8)




Figura 8

3. Vendos numrin personal të Identifikimit në fushën përkatëse si në figurën 9.




Figura 9

4. Vendos fjalëkalimin që është dërguar me SMS si në figurën 10



Figura 10

5. Shtyp butonin HYR (shiko figurën 11)





**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*




Figura 11

6. Pasi keni shtypur HYR do ju shfaqet në ekran kjo dritare me këtë përmbajtje (duke specifikuar emrin, pozicionin, datën e orën) si në figurën 12





Figura 12


7. Në rastin kur duhet të raportosh kliko (shtyp) butonin “Raporto” si në figurën 13



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*



8. Në rastin kur Sekretari do të ngarkojë dokument (foto vendimi/ procesverbali hapje/ mbyllje) kliko butonin “Ngarko Dokumentacion” si në figurën 14



## II. Platforma Microsoft TEAMS

Sekretari i KZAZ-së mban komunikime të vazhdueshme me KQZ-në si dhe ngarkon dokumente apo kërkesa nëpërmjet platformës Microsoft TEAMS dhe postës elektronike të saj.

KQZ pajis me laptop dhe kredencialet (emër përdoruesi/username dhe fjalëkalim/password) për të aksesuar platformën.

Emri i përdoruesit është [kzaz.11@kqz.gov.al](mailto:kzaz.11@kqz.gov.al). Fjalëkalimi i gjeneruar nga KQZ i komunikohet sekretarit të KZAZ-së. Në rastin e zëvendësimit të sekretarit të KZAZ-së, kredencialet i dorëzohen sekretarit të sapoemëruar duke evidentuar dorëzimin e detyrës në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së.

Sekretari i KZAZ-së komunikon në platformën e komunikimit me stafin e KQZ-së për çdo kërkesë, informacion, sqarim apo ngarkim kërkesa/ dokumentacioni të nevojshëm. Komunikimi në këtë platformë është zyrtar.

## III. Ndërplatformat Whatsapp dhe Telegram

KQZ për t’ju ardhur në ndihmë anëtarëve të KZAZ-së vendos në dispozicion numrin e celularit 0694003072 për të komunikuar në platformat Whatsapp dhe Telegram.



## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

### KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”

Çdo anëtar i KZAZ-së ftohet me lidhjen përkatëse që të bëhet pjesë e grupit. Për t’u bërë pjesë e grupit anëtar i KZAZ-së mund të skanojë nga aparati i tij telefonik kodin QR në telegram dhe në Whastapp si më poshtë:



Këto mjete komunikimi shërbejnë për të marrë udhëzime & informacione në kohë reale nga KQZ. Çdo anëtar i KZAZ-së apo subjekt i interesuar mund të telefonojë pa pagesë në numrin 08000803.

### 3.2 Përbërja e KZAZ, parimet e përgjithshme dhe rregullat e etikës

Në këtë temë do të trajtohen rregullat e etikës, njohja e tyre dhe domosdoshmëria e zbatimit të tyre si ligjshmëria, transparenca, kolegialiteti, paaësia, pavarësia dhe objektiviteti.

KZAZ përbëhet nga 7 anëtarë dhe një sekretar i cili është pa të drejtë vote. Konkretisht KZAZ 11, përbëhet nga 3 anëtarë të PS, 2 anëtarë të PL dhe 1 anëtar të PD. Anëtar i shtatë është përcaktuar nga KQZ dhe i takon PS. Kryetari është i PS dhe nënkryetari i PL. Anëtarët e KZAZ duhet të gëzojnë të drejtën për të qenë zgjedhës e të jenë me vendbanim në zonën përkatëse zgjedhore si dhe të kenë arsimin e lartë. Sekretari i KQV duhet të jetë me profesion jurist.

### 3.3 Rastet e shkarkimit, lirimit në KZAZ

Në këtë temë do të bëhet diferenca mes konceptit të shkarkimit dhe lirimit nga detyra si dhe kushtet e shkarkimit apo lirimit. Do të trajtohet organi që kryen procedurën e shkarkimit apo lirimit të anëtarit apo sekretarit të KZAZ si dhe procedura që ndiqet për këtë vendimmarrje.

Shkarkimi i anëtarit të KZAZ ndodh për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve apo kur shkelin dispozita që burojnë nga Kodi Zgjedhor si p.sh kur mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se



## **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

### **KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

3 mbledhje rresht në KZAZ apo kur, në periudhë zgjedhore, nuk paraqiten në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht.

Organi që shkarkon anëtarin e KZAZ është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i cili mund të veprojë kryesisht apo me propozim të subjekteve zgjedhore.

Lirimi nga detyra ndodh në rastet kur anëtari apo sekretari i KZAZ ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit (marrëdhënie krushqie apo marrëdhënie pune me kandidatët që konkurrojnë zonë), kur nuk ka vendbanim në zonën zgjedhore apo kur nuk plotëson kushtet për të qenë zgjedhës.

Organi që liron nga detyra anëtarin apo sekretarin e KZAZ është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

### **3.4 Trajtimi i vakancave në KZAZ**

Do të trajtohet vakanca e krijuar në rastin e dorëheqjes së anëtarit apo sekretarit të KZAZ apo në rastin e shkarkimit e lirimit të tij nga detyra si dhe procedura që ndiqet për njoftimin e vakancës dhe plotësimin e saj.

Për të dhënë dorëheqjen duhet që anëtari i KZAZ të depozitojë deklaratën e dorëheqjes me shkrim në KZAZ dhe sekretari njofton menjëherë me shkrim KQZ dhe përfaqësuesin e partisë politike përkatëse duke i bashkëngjitur deklaratën e dorëheqjes.

Është e rëndësishme të thuhet që anëtari i dorëhequr nuk mund të largohet pa dorëzuar detyrën tek anëtari që do ta zëvendësojë atë.

### **3.5 Detyrat e KZAZ**

Në këtë temë trajtohen detyrat në tërësi të KZAZ dhe në veçanti të kryetarit dhe sekretarit të KZAZ. Në këtë temë trajtohen detyrat në tërësi të KZAZ dhe në veçanti të kryetarit dhe sekretarit të KZAZ.

Gjithashtu, specifikohet se në selinë e KZAZ, në hyrje të ndërtesës ku është vendosur selia e KZAZ, vendoset tabela treguese e KZAZ e cila përmban numrin e zonës së Administrimit zgjedhor, emrat e anëtarëve të KZAZ, orarin e punës numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike të KZAZ.

Gjatë ushtrimit të detyrës anëtarët dhe sekretari i KZAZ janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit të funksionit që ata kanë. Po kështu edhe vëzhguesit e akredituar.

### **3.6 Mbledhjet dhe vendimet e KZAZ**

Kjo çështje trajton mënyrën sesi merren vendimet dhe cilat janë llojet e vendimeve që një KZAZ mund të marrë. Trajtohen dhe shpërndahen modelet e vendimeve të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Organizimi i mbledhjeve, orari i punës dhe dokumentimi i mungesave të anëtarëve të KZAZ-së.

Orari i punës së KZAZ-së është paradite 09:00-13:00 dhe pasdite 16:00-20:00.

Trajtimi i kërkesave të subjekteve/ zgjedhësve për çështje që lidhen me administrimin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore.

Mbledhjet e KZAZ janë publike dhe janë të vlefshme kur në të marrin pjesë shumica e anëtarëve të KZAZ. Ato zhvillohen vetëm në ambientet e KZAZ. Mbledhjet thirren nga kryetari. Njoftimi për mbledhjen e KZAZ vendoset nga sekretari në hyrje të zyrës së KZAZ të paktën 24 orë përpara orës së mbledhjes dhe përmban orën, datën dhe çështjet që do të diskutohen.

Gjatë mbledhjes anëtarët dhe sekretari u ndalohej çdo lloj komunikimi me telefon apo me forma të tjera komunikimi me të tretët. Sekretari i KZAZ mban procesverbal në LPM në të cilin vendos orën, datën anëtarët që morën pjesë, çështjet që diskutohen.



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHETETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

Vendimet merren me votim të hapur me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZAZ. Votimi bëhet me ngritjen e dorës apo me deklaram.

Anëtari voton pro ose kundër dhe rezultatet e votimit shënohen nga sekretari në LPM. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët që morën pjesë.

Sekretari jo më vonë se 24 orë nga marrja e vendimit kryen zbardhjen e tij në formatin e miratuar nga KQZ. Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KZAZ, duke shënuar edhe votën pro apo kundër në këtë model vendimi.

Vendimet vulosen nga sekretari. Sekretari përgatit kopje të vendimeve dhe ua jep atë pa pagesë subjekteve të interesuara apo vëzhguesve brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës si dhe për administrim në arkivin e KZAZ. Vendimet regjistrohen në regjistrin e vendimeve të KZAZ.

### 3.7 Dokumentacioni i punës së KZAZ

Kjo çështje trajton dokumentacionin e punës së KZAZ si librin e protokollit të mbledhjeve Librin e vendimeve, regjistrin e korrespondencës apo procesverbalin e konstatimeve. Libri i protokollit të mbledhjeve mbahet nga sekretari i KZAZ ashtu sikurse i gjithë dokumentacioni i KZAZ. Në librin e vendimeve shënohen vendimet që KZAZ ka marrë me numrat përkatës të tyre. Libri i korrespondencës reflekton të gjitha shkresat që hyjnë apo dalin nga KZAZ. Procesverbali i konstatimeve përdoret për të regjistruar parregullsitë, pasaktësitë e konstatuara gjatë procesit të numërimit të votave. Ky procesverbal mbahet dhe administrohet nga sekretari.

Gjithashtu trajtohen llojet e procesverbaleve apo vendimeve që plotësohen nga KZAZ. Shpërndahen modelet e miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Dokumentacioni i punës do të jetë sipas vendimit nr. 32, datë 3.2.2023 “Për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës së Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

### 3.8 Regjistrimi i komiteteve nismëtare

Komitetet nismëtare duhet të paraqesin kërkesë për regjistrim në KZAZ 11, jo më vonë se data 1 Shtator 2023 (sipas modelit të miratuar nga KSHZ), shoqëruar edhe me një kopje të dokumentit të identifikimit për secilin nga anëtarët e Komitetit Nismëtar. KZAZ kthen për plotësim dokumentacionin brenda 24 orëve nga dorëzimi. Dokumentacioni i korrigjuar nga komiteti nismëtar dorëzohet në KZAZ brenda 24 orëve nga kthimi për plotësim. KZAZ me vendim, miraton kërkesën për regjistrim brenda 24 orëve nga ridërgimi i dokumentacionit, përmes modelit të vendimit për regjistrimin e komitetit nismëtar.

### 3.9 Regjistrimi i kandidatit për kryetar të bashkisë

Dokumentet e kandidimit paraqiten në KZAZ 11 jo më vonë se data 8 Shtator 2023. KZAZ bën verifikimin e tyre jo më vonë se 24 orë nga paraqitja dhe në rast se vëren parregullsi i kthen ato për



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

plotësim. Dokumentet e plotësuar riparqiten në KZAZ jo më vonë se 24 orë. KZAZ merr vendim jo më vonë se 24 orë nga riparqitja e tyre.

Kërkesë (sipas modelit KQZ-04-06) në KZAZ, për regjistrimin e kandidatit për kryetar të bashkisë Kukës, mund të paraqesë partia politike apo koalicioni të regjistruar në KQZ. Kërkesa (sipas modelit KQZ-04-05) për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit mund të paraqitet nga komiteti nismëtar i regjistruar në KZAZ. Bashkëlidhur kërkesës subjekti duhet të paraqesë formularin për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati (nëse kandidati nuk ka mandat deputeti apo këshilli të bashkisë). Subjekti duhet të sigurojë mbështetje nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1% të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por në çdo rast jo më pak se 50 zgjedhës. Formulari shoqërohet edhe me fotokopje të identifikimit të vlefshëm të nënshkruar nga çdo zgjedhës.

Kërkesat për regjistrim kandidati duhet të shoqërohen edhe me deklaratën për pranimin e kandidimit të nënshkruar nga kandidati sipas modelit KQZ-04-09 si dhe jetëshkrimi i kandidatit sipas modelit KQZ-04-10. Një dokument tjetër bashkëlidhur kërkesave është edhe deklarata e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme (sipas modelit KQZ-04-08) e cila është detyruese vetëm nëse kandidati do të përfitojë fonde jopublike si dhe vërtetim që zotëron mandate deputeti apo anëtar të këshillit të bashkisë. Për marrjen në dorëzim të dokumenteve të kandidimit plotësohet procesverbali i dorëzimit të dokumenteve të kandidimit sipas modelit KQZ-00-31.

### 3.10 Detyra të KZAZ për krijimin dhe funksionimin e qendrës së votimit

Partitë politike sjellin propozimet në KZAZ jo më vonë se data 1 Shtator 2023. Pas shqyrtimit të propozimeve, KZAZ merr vendim për emërimin e anëtarëve të KQV, jo më vonë se data 4 Shtator 2023.

Sa i përket anëtarit të shtatë të KQV, KZAZ rendit qendrat e votimit brenda juridiksionit të saj nga numri më i vogël tek numri më i madh dhe më pas vendos numrin natyror duke filluar nga numri 1 e në vazhdim përbri renditjes së qendrave të votimit.

Në qendrat e votimit që kanë një numër natyror çift, anëtar i shtatë i takon subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, ndërsa në qendrat e votimit që kanë një numër natyror tek, anëtar i shtatë i takon subjektit zgjedhor Partia e Lirisë.

### 3.11 Afishimi i listës së zgjedhësve dhe verifikimi i objekteve zgjedhore

Në këtë temë do të trajtohen kërkesat e kodit zgjedhor dhe akteve nënligjore të cilat ngarkojnë me detyra KZAZ-në dhe pushtetin vendor.

KZAZ sapo të administrojnë listat përfundimtare të zgjedhësve brenda 4 ditëve duhet të afishojnë listat e zgjedhësve në ambientet e jashtme të qendrave të votimit.

KZAZ kryen verifikimin e ambienteve të qendrave të votimit dhe raporton në KQZ për gjendjen e tyre në përputhje me pyetësin e dërguar në formë elektronike në aplikacionin KQZ.



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

### 3.12 Detyra të KZAZ për organizimin e VNV

Do të trajtohen kushtet që duhet të ketë një VNV, skemën organizative të VNV, pajisjet logjistike dhe verifikimi i funksionalitetit të tyre. Roli i Policisë së Shtetit në marrjen në ruajtje të VNV dhe raporti i KZAZ me policinë e shtetit.

### 3.13 Detyra të KZAZ për krijimin e grupeve të numërimit të votave

KZAZ 11 krijon 10 GNV (grupe të para). Grupet e numërimit përbëhen nga 4 persona nga të cilët një është numërues i parë, një sekretar dhe 2 anëtarë.

Në GNV me numër çift numëruesi i parë emërohet nga PS dhe sekretari nga PL, ndërsa në GNV me numër tek, numëruesi i parë emërohet nga Partia e Lirisë dhe sekretari nga Partia Socialiste.

### 3.14 Detyra të KZAZ për akreditimin e vëzhguesve

KZAZ akrediton vëzhgues të subjekteve zgjedhore kur kjo kompetencë delegohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje paraqesin kërkesën për akreditim të vëzhguesve në KZAZ 11, jo më vonë se data 22 Shtator 2023.

Lista e vëzhguesve të propozuar nga subjektet zgjedhore duhet të jetë e nënshkruar nga kryetari i partisë politike apo përfaqësuesi i autorizuar prej tij partia udhëheqëse e koalicionit apo kandidati i propozuar nga zgjedhësit.

Tregohet modeli i listës së vëzhguesve të propozuar nga subjektet zgjedhore. Krahas listës, depozitohet dhe vetëdeklarimi i vëzhguesit për gjendjen gjyqësore. KZAZ shqyrton dokumentacionin.

Dy janë kriteret për të qenë vëzhgues :

- të gëzojë të drejtën për të qenë zgjedhës,
- të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Pas verifikimit të dokumentacionit, KZAZ merr vendim sipas modelit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Bashkëlidhur çdo vendimi për miratim duhet të jetë edhe lista e paraqitur nga subjektet zgjedhore për vëzhgues KZAZ-KQV-GNV me dokumentacionin përkatës (deklaratë dhe ID) dhe plotësimin e badge për çdo vëzhgues.

### 3.15 Shpërndarja në kohë e materialeve të votimit

KZAZ harton grafikun për shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit të KQV. Planifikohen që fillimisht të shpërndahen materialet për KQV më të largëta. Puna për shpërndarjen e materialeve fillon në orën 15.00 të datës 23 Shtator 2023. Në këtë proces KZAZ përdor modelet e procesverbaleve të miratuara nga KQZ.

Procesverbali për marrjen në dorëzim të dokumentacionit KZAZ - KQV duhet të plotësohet saktë (të gjitha zërat) dhe të firmoset nga KZAZ dhe KQV (kryetar/sekretar).



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
*Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KZAZ-së”*

### 3.16 Marrja në dorëzim e materialeve të votimit

Materialet e votimit merren në dorëzim nga KZAZ. Njihen me mënyrën se si caktojnë grupet e marrjes në dorëzim si dhe dokumentacioni që plotësohet për marrjen në dorëzim të materialeve të votimit. Si vepron KZAZ në rast se paraqiten kuti të cilat janë të parregullta.

### 3.17 Tabelat e rezultateve

Fillimisht, në funksion të procesit të numërimit të votave, KZAZ ngre GNV sipas propozimeve të subjekteve zgjedhore; Numërimi i fletëve të votimit kryhet nga GNV dhe kontestimi i fletëve të votimit mund të bëhet nga GNV, ndërsa KZAZ kryen gjithmonë vlerësimin e fletëve të votimit pas kontestimit të GNV. Procesi vijon me hedhjen e të dhënave nga operatori në tabelën e rezultateve për çdo qendër votimi sipas numërimit të bërë nga GNV (KQZ– 00-26) si dhe me plotësimin e tabelës përmbledhëse për çdo qendër votimi (KQZ– 00 -29). Menjëherë pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha QV-ve dhe hedhjes e transmetimit elektronik të rezultateve për çdo Qendër votimi në KQZ, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për kryetar bashkie për ZAZ-në Kukës. KZAZ merr vendim për miratimin e tabelës përmbledhëse për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kukës. (KQZ-01 – 08).

KZAZ do të njihet me shembujt e modeleve të vlerësimit të votave sipas akteve nënligjorë në fuqi si dhe njohja me vendimmarrjet e KAS apo Kolegjit Zgjedhor për çështje të tilla.

### 3.18 Dorëzimi i materialeve në KQZ

Në këtë temë trajtohen se cilat dokumente janë të domosdoshme për t’u dorëzuar në KQZ.

KZAZ pasi ka shpallur fituesin e zgjedhjeve për kryetar bashkie, koordinon me KQZ-në për orën dhe vendin e dorëzimit të materialeve zgjedhore.

Kryetari dhe sekretari i KZAZ dorëzojnë tabelat e rezultateve; Vendimet e emërimit/lirim/shkarkim anëtar/kryetar/sekretar me dokumentacionin përkatës deklaratë/ID;

Vendimet e emërimit/shkarkim të anëtarëve të GNV (me dokumentacionin përkatës deklaratë/ID); Vendimet për akreditim vëzhguesish, si dhe çdo dokumentacion tjetër pranë zyrës së protokollit.

Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore, pajisja PEI, kamerat në QV dhe çdo material tjetër dorëzohet në magazinat e KQZ-së përkundërt procesverbalit përkatës.

## 4. MATJA E REZULTATEVE TË TRAJNIMIT

Vlerësimi do të bëhet nëpërmjet vlerësimit të angazhimit të komisionereve në temat dhe kazuset, intervistimi dhe trajtimi i problematikave nëpërmjet rasteve ilustruese.